



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORI

Nr. 71 Prot.

Tiranë, më 09.01, 2023

URDHËR
Nr. 2, datë 09.01, 2023

PËR NJËSIMIN E DOKUMENTIT ADMINISTRATIV

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 11, pika b, të Ligjit nr. 9154, datë 06.01.2003 "Për arkivat" si dhe të pikës 1, 2 të nenit 4, të Vendimit me nr. 4, datë 19.6.2017 "Për miratimin e rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Dokumentet administrative të përpiluara sipas Normave tekniko-profesionale të Republikës së Shqipërisë duhet të jenë në përputhje me modelet bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Siglimi i kopjes së dytë të dokumenteve kryhet, si më poshtë:
Konceptoi: *Nistore e emrit, pikë, mbiemri i plotë, nënshkrimi i konceptuesit.*
Pranoi: *Nistore e emrit, pike, mbiemri i plotë, nënshkrimi i përgjegjësit të strukturës së nivelit të parë' (nëse ka).*
Miratoi: *Nistore e emrit, pikë, mbiemri i plotë, nënshkrimi i përgjegjësit të strukturës së nivelit të dytë (nëse ka).*
Konfirmoi: *Nistore e emrit, pikë, mbiemri i plotë, nënshkrimi i zëvendësullarit, juristi, apo pozicionit tjetër të përcaktuar në rregulloren e brendshme të funksionimit të Universitetit të Sporteve të Tiranës. (Në rastin me më shumë se dy nivele strukturore, si p.sh.: departamentet/drejtoritë, apo raste të tjera, siglimi i strukturës së nivelit të tretë kryhet njësoj si nga struktura e nivelit të dytë.)*
3. Dokumentet të përpilohen me shkrim *Times New Roman*, me madhësi 12 dhe hapësira midis rreshtave të jetë 1.15, si dhe në anësore të lihen 3 cm bosh, ndërsa në krye e në fund të faqes nga 2 cm.
4. Dokumentet të përpilohen në bazë të rregullave drejtshkrimore, ku të përdoren gërmat (ë) dhe (ç), si dhe kryeradhët.
5. Struktura të shënohet në dokumentet administrative vetëm në nivelin e

strukturës më të lartë (Departamentit ose Drejtorisë, ose Sektorit etj, sipas rastit) që ka konceptuar dokumentin. Titullari i institucionit është strukturë më vete, në rastin e dokumenteve të konceptuara nga ai dhe në këto dokumente shënohet si strukturë më vete emërtesa e titullarit sipas organikës.

6. Përjashtimisht, në rastet kur dokumentet janë produkt i pozicioneve të posaçme të punës, të parashikuara në ligj dhe që nuk janë strukturë më vete, pozicionet shënohen poshtë strukturës përkatëse, ku ndodhet pozicioni i posaçëm, sipas rastit, Struktura Përgjegjëse për Sinjalizuesit, Autoriteti Përgjegjës për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Koordinatori për të Drejtën e Informimit.
7. Njësia e Prokurimeve, Njësia e Ankandeve, Grupi i Menaxhimit Strategjik., grupet *ad-hoc* të punës, Komisioni Disiplinor, Komisioni i Ekspertizës, si dhe të gjitha njësitë e tjera të ngritura sipas ligjit specifik në nivelin më të lartë drejtues, shënohen si nënstrukturë, poshtë strukturës me emërtesën e titullarit, sipas organikës së institucionit.
8. Specialisti i Arkiv/Protokollit të institucionit njofton titullarin në të gjitha rastet kur shkresat nuk përpilohen sipas këtij urdhri.
9. Ngarkohen strukturat e Universitetit të Sporteve të Tiranës, pozicionet e posaçme të punës, sipas ligjit, dhe Specialisti i Arkiv/Protokollit për zbatimin e këtij urdhri.
10. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. Dr. Agron K...



Konceptoi Drejtorë: L. Shehu

Numri i kopjeve origjinale: 3 (tre)